



KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

V E N D I M
Nr. 54, datë 25.04.2016

MBI
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË STRUKTURËS SË POSAÇME PËR RREGJISTRIMIN,
ADMINISTRIMIN DHE PËRPUNIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT
PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur më datë 25.04.2016, mbështetur në Kushtetutën e Republikës, në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në Vendimin nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe në vendimin nr. 39, datë 11.4.2016, të KLD-së,

V E N D O S I :

- I. Ngritjen e strukturës së posaçme për rregjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i përbërë si më poshtë:
 - Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Administratës dhe Financës;
 - Androkli Xhaferaj, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve;
 - Suela Zhegu, specialiste e burimeve njerëzore.
- II. Drejtorja Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit, në çdo rast të ofrojë asistencë juridike dhe me burime njerëzore (zj. Amanda Karapici dhe zj. Ilma Bici), për mbarëvajtjen e këtij procesi.
- III. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtorja e Administratës dhe Financës dhe Drejtorja Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit të Mbledhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË


KRYETARI
BUJAR NISHANI

